



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Tiranë, më 23.12.2020

Nr. 6054/ Prot.
132

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje me dyer të mbyllura)

(Mbajtur, më 28.09.2020)

Pika 21 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit : , relator Ilir Toska (vijim i shqyrtimit nga mbledhja e datës 16.01.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 12:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Naureda Llagami (kryetare)
2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)
3. Medi Bici (anëtar)
4. Fatmira Luli (anëtare)
5. Brunilda Kadi (anëtare)
6. Dritan Hallunaj (anëtar)
7. Ilir Toska (anëtar)
8. Brikena Ukperaj (anëtar)
9. Marçela Shehu (anëtare)
10. Erjon Muharremaj (anëtar)

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 28.09.2020 (Pika 21)



Shënim: Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Alban Toro*.

RENDI I DITËS:

21. Shqyrtimi i projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit _____, relator Ilir Toska (vijim i shqyrtimit nga mbledhja e datës 16.01.2020).

Fillimisht zonja Llagami informon mbi një e-mail të ardhur në postën elektronike të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Gjykatës së Lartë, të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe të stafit administrativ të tij. Në këtë e-mail flitet për pasaktësi të dhënash të deklaruara nga kandidati

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska, i cili fillimisht iu shpërndan anëtarëve një shkresë të ardhur nga Institucioni i Komisionerit Publik, që bën fjalë për refuzimin e dorëheqjes së Komisionerit Publik _____ për rastin e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës _____ .
Më tej parashtron se ai si relator nuk ka arritur të përgatisë një relacion shtesë mbi dokumentacionin e administruar në procedurën e verifikimit të kandidatit, pas mbledhjes së janarit 2020, kjo për shkak të kohës së shkurtër nga momenti që u përzgjedh si relator, vetëm ditën e enjte, pra më datë 24.09.2020, ndërsa parashtron edhe një sërë arsye të tjera që lidhen me ngarkesën në punë, për materiale të vlerësuara urgjente, që janë përfunduar nga ai ditën e premte, si p.sh. përfundimi dhe dërgimi anëtarëve të projektvendimit “Për verifikimin e kancelarëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë” apo përmbyllja e informacionit të kërkuar me urgjencë nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të rezolutës që Kuvendi ka miratuar për Këshillin.

Gjithashtu edhe z. Toska informon anëtarët mbi e-mailin e ardhur në adresë të Këshillit duke ngritur pyetjen nëse duhet të merret në konsideratë ky e-mail për të bërë verifikimin e atyre problematikave që evidentohen në të në lidhje me kandidatin _____ konkretisht për faktet e pretenduara se kandidati nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë qenien ortak në një shoqëri tregtare, apo faktin se ai ka kandiduar për këshilltar, në zgjedhjet vendore të vitit 2011, nën siglën



e dy partive politike, duke nënkuptuar, dërguesi i e-mailit, se ka kandidati është para kushteve ndaluese të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, etj.

Sa i përket faktit që ka qenë ortak në një shoqëri tregtare, i pyetur nga anëtarët, z. Toska sqaron se kandidati në fakt e ka bërë një deklaram të tillë. Sipas akteve kandidati nuk e ka bërë këtë deklaram në deklaratën e pasurisë, por në një deklaratë shoqëruese të deklaratës së pasurisë, dokumente këto që janë dorëzuar në ILDKPKI, ndërsa kjo e fundit ka marrë informacione edhe në këtë drejtim, duke evidentuar të dhënat në raportin e kontrollit. Sa i përket faktit të anëtarësisë në parti politike dhe specifikisht për mbajtjen e pozicioneve drejtuese në to, gjatë verifikimit fillestar, sipas edhe relacionit të shqyrtuar nga Këshilli në janar 2020, është marrë informacion nga gjykata e regjistrimit të partive politike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informacion sipas të cilit një fakt i tillë nuk konfirmohet.

Zonja Kadi merr fjalën dhe është e mendimit që nëse kandidati ka pasur këtë situatë (sipas ligjit) i bie që duhet të ishte skualifikuar si Komisioner.

Zonja Ukperaj shton më tej sa i përket faktit që kandidati figuron ortak në një shoqëri, që ILDKPKI ka bërë hetim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila i ka sjellë të dhënat e saj lidhur me këtë çështje Inspektoratit, ku kandidati figuron ortak me 10%.

Më tej merr fjalën **zonja Llagami** duke drejtuar pyetjen nëse duhet të bëjë Këshilli një hetim mbi problematikat që evidentohen në e-mail, kjo edhe në kuadrin e shtyrjes që propozon z. Toska në cilësinë e relatorit?

Z. Muharremaj merr fjalën për të propozuar marrjen e një informacioni nga 2 partitë që citohen në e-mail mbi kandidimin apo jo të kandidatit në zgjedhje vendore nën siglën e këtyre dy partive politike, qenien e tij anëtar i tyre dhe mbajtjen në to të pozicioneve drejtuese gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit.

Gjithashtu edhe **zonja Luli**, gjatë diskutimeve më herët pyet mbi skualifikimin e ... për shkak të mungesës së eksperiencës prej 15 vitesh, kur kandidati konkurronte për në KLP/KLGJ, fakt i konstatuar në raportin e Kuvendit dhe propozimi i saj është që t'i kërkohet Kuvendit dosja e plotë, raporti i Kuvendit bashkë me dokumentacionin.

Ndërsa edhe **zonja Ukperaj** vjen me propozimin sa i përket përkthimit të ligjit grek të Avokatisë (4194), konkretisht përkthimin e plotë të disa dispozitave të tij, neneve 1 deri 23, pasi

në materialet e administruara gjatë procedurës së verifikimit këto dispozita nuk janë të përkthyer në mënyrë të plotë.

Hidhen në votim tre propozimet (z. Muharremaj, znj. Luli dhe znj. Ukperaj), për të cilat anëtarët prezent në Këshill janë dakord: 1- Marrja e një informacioni nga 2 partitë që citohen në e-mail në lidhje me qenien e kandidatit; 2- anëtar i tyre dhe mbajtjen në to të pozicioneve drejtuese gjatë 10 viteve të fundit para kandidimit për në Gjykatën e Lartë; 3- Kërkimi Kuvendit të Shqipërisë të dokumentacionit të plotë, bashkë me raportin, që i përket kandidimit të z.Darjel Sina në procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të KLP/KLGJ; 4- Përkthimi i plotë i dispozitave të ligjit grek të Avokatisë (4194), neneve 1-23.

* * *

(Pika 21 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare
NAURE DALLAGAMI

Zëvendëskryetar
MAKSIM OOKU

Anëtar
MEDI BICI

Anëtar
ILIR TOSKA

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
FATMIRA LULI

Anëtare
BRUNILDA KADI

Anëtare
MARCELA SHEHU

Anëtar
ERJON MUHARREMAJ

Anëtar
DRITAN HALLUNAJ

Mbajtur, Specialiste

Rosalba Xhabrahimi

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 28.09.2020 (Pika 21)